



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 688/1 Prot.

Tiranë, më 23. 05. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 127, Datë 23. 05. 2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 66, datë 17.05.2018, e shtetasit A. Z., kundër Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të bindjeve politike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Sipas parashtrimeve të bëra në ankesë, A. Z. ka qënë punonjës i Policisë së Shtetit në pozicionin “*Specialist turni për drejtimin dhe komandimin në seksionin e sallës së komandimit, në Sektorin e Rendit Publik*”, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, me gradë policore “*Nënkomisar*”. Më datë 09.08.2015, ankuesi ka qënë në shërbim në sallën e Drejtimit dhe Komandimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, së bashku me një koleg. Pas përfundimit të shërbimit, në ambjentet e sallës së komandimit është paraqitur shtetasi B. D., i cili do të merrte shërbimin që po dorëzohej në ato momente nga ankuesi. Sipas ankuesit, kolegu i tij, shtetasi Bujar Dingu, gjatë ndërrimit të shërbimit e ka provokuar dhe ofenduar rëndë, duke përfunduar në një debat me njëri tjetër. Me ndërhyrjen e kolegëve të tjerë të pranishëm situata nuk ka agravuar. Pas këtij momenti, shtetasi Bujar Dingu, ka njoftuar eprorët e tij lidhur me ngjarjen e ndodhur, si dhe Drejtorin e Policisë së Qarkut në atë kohë J. Ç. Në këto kushte, nga ana e Drejtorit të Policisë së Qarkut, ankuesi është vënë në dijeni të shkresës nr. 12/106 prot., datë 10.08.2015 “*Për fillimin e ecurisë disiplinore*”, si dhe të shkresës nr. 12/105 prot., datë 11.08.2015 “*Për pezullimin paraprak*”, të ankuesit nga data 10.08.2015 deri më datë 08.09.2015. Referuar informacionit të administruar, Drejtoria e Standardeve Profesionale, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, në raportin përfundimtar të saj ka konkluduar se: “*nga punonjësi i policisë A. Z. janë*

*kryer shkelje të rënda disiplinore të parashikuara nga neni 11, pika 5 e Ligjit për Policinë e Shtetit*". Më pas, Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë, me anë të vendimit Nr. 230, datë 02.09.2015, për shkelje të rëndë disiplinore ka përjashtuar nga Policia e Shtetit ankuesin.

Në këto kushte, ankuesi ka kundërshtuar në Komisionin e Apelit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, masat e marra nga Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë. Duke qënë se nga ana e Komisionit të Apelit të Drejtorisë së Policisë së Shtetit nuk është marrë në konsideratë ankimi i bërë nga A. Z., atëherë Drejtori i Policisë së Qarkut Vlorë ka urdhëruar përfundimisht përjashtimin e ankuesit nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Ankuesi duke mos qënë dakord me vendimin e largimit nga puna, i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka vendosur shfuqizimin e urdhërave për largimin nga puna dhe ka rrëzuar kërkimin e ankuesit për rikthimin në punë. Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Administrative të Apelit Tiranë për kundërshtimin e këtij vendimi, por ende nuk është marrë një vendim përfundimtar.

Në përfundim të ankesës, A. Z. kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese për shkak të bindjeve politike, të kryer nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, si dhe të vendosë rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

**Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 66, datë 17.05.2018, Komisioneri konstatoi se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër"*.

Bazuar në nenin 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Referuar në ankesën nr. 66, datë 17.05.2018, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të tij, Komisioneri vlerëson se, A. Z. është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese

të pretenduara nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, nëpërmjet shkresave për largimin e tij nga puna, në muajin Tetor 2015.

Për sa më sipër, diskriminimi i pretenduar nga A. Z., sipas informacionit të dhënë prej tij ka ndodhur, si dhe ka marrë dijëni për të, në Tetor të vitit **2015**, ndërkohë që ankesa pranë Komisionerit është paraqitur në datën **17.05.2018**. Në këtë kontekst, rezulton se ankesa është paraqitur pranë KMD-së, më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit dhe një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për diskriminimin e ndodhur. Pra, ankesa është depozituar tej afateve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në këto kushte dhe referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, **ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.**

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e saj nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje”,* ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 66, datë 17.05.2018, të shtetasit A. Z., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj, të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”.
2. Rekomandimin e subjektit ankues që pretendimin për diskriminim, ta ndjekë gjyqësisht, në zbatim të nenit 36, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

---

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet Politike)

(Fusha: Punësim)